

BULETINI I RIMËKËMBJES

maj 2021



Për buletin

Buletini i Rimëkëmbjes është publikim periodik i Institutit për Politika Zhvillimore – INDEP, që shpalos dhe i ofron publikut informata të përgjithshme rreth masave të ndërmarra nga institucionet e Republikës së Kosovës, sa i përket rimëkëmbjes ekonomike. Masat e përmendura janë inicuar me qëllim të mundësimit të rimëkëmbjes ekonomike në vend, pas pasojave të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Përveç se të informojë qytetarët rreth masave të rimëkëmbjes, buletini synon të paraqesë nivelin e zbatimit të masave krahas inkurajimit të hisedarëve drejt monitorimit të zbatimit të tyre.

Gjithsesi, ky edicion i radhës vjen më ndryshe se buletinët e kaluar. Quhet Edicion i Shpejtë sepse ka për qëllim informimin e shpejtë të qytetarëve për masat e reja mbështetëse të cilat kanë një afat më të shkurtër kohor dhe për procedurat e aplikimit. Buletini shtjellon temën e subvencionimit të shoqërive tregtare (bizneseve), përkatësisht subvencionimin e pagesës së punëtorëve dhe subvencionimin e pagesës së qirasë për bizneset që kanë pësuar rënie të ndjeshme në të hyra për shkak pandemisë COVID-19 dhe kufizimeve të vendosura. Këto masa janë si pjesë e Vendimit Nr. 01/05, të datës 05.04.2021, të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Buletini i Rimëkëmbjes realizohet në kuadër të projektit “Barometri i Rimëkëmbjes – për transparencë dhe llogaridhënie” mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).



Vendimet e reja të Qeverisë: ndikimi dhe përfitimet në kategori të caktuara të bizneseve

Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike përmes nenit Neni 6 - Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ka përfshirë mbështetjen e prodhuesve vendorë. Përmes këtij neni, Qeveria ofron përkrahje për prodhuesit vendorë me qëllim rimëkëmbjen ekonomike të vendit e cila pësoi rënie nga pandemia COVID – 19 duke larguar këshu TVSH-në për transaksionet e sigurimit dhe ri-sigurimit në bujqësi, për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore në Kovovë. Ky nen thekson:

Vendimi Nr. 01/05, i datës 05.04.2021 i Qeverisë së Kosovës ka pezulluar përkohësisht aktivitetet e këtyre shoqërive tregtare në këtë formë:

- Sektori i gastronomisë ka shërbyer vetëm me dërgesa me porosi, "merr me vete" dhe "drive-through"
- Është ndaluar veprimtaria e qendrave tregtare të mbyllura
- Është ndaluar aktiviteti në hapësira të mbyllura të palestrave dhe fitneseve

Për të mbështetur kategoritë e caktuar të bizneseve të lartpërmendura, të cilat janë prekur nga Vendimi paraprak Nr.01/05, i datës 05.04.2021, Qeveria e Republikës së Kosovës merr vendimin e radhës Nr. 08/08, i cili hyn në fuqi me datë 21.04.2021

6,000,000 € (gjashtë milion euro) janë ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës për subvencionimin e dis kategorive të shoqërive tregtare (bizneseve)

Sipas këtij vendimi, ndahen mjete buxhetore në vlerë prej 6,000,000 € (gjashtë million euro) nga Programi për Rimëkëmbje Ekonomike për të subvencionuar shoqëritë tregtare (bizneset) që kanë pësuar rënie në të hyra, si pasojë e mbylljes së përkohshme që ka rezultuar pas marrjes së Vendimit Nr. 01/05, i datës 05.04.2021.

Kategoritë e caktuara të bizneseve mbështetën me mjete financiare të ndara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për:

- Pagat e punëtorëve dhe/ose
- Pagesën e qirasë



Kush ka të drejtë të aplikojë për masat e reja mbështetëse?

Për këtë subvencionim kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë tatimpaguesit të cilat kanë pësuar rënie në të hyra për shkak të kufzimeve të vendosura sipas Vendimit Nr. 01/05, të datës 05.04.2021, të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Subvencionimi i pagës së punëtorëve bëhet deri në nivelin 50% të pagës neto të të punësuarve e llogaritur mbi pagën bruto dhe duke qenë i liruar nga tatimi sipas legjislacionit në fuqi, deri në maksimum prej 500 EUR. Rimbursimi bëhet në llogarinë e punëtorit. Bizneset që kanë të drejtë të aplikojnë sipas kriterëve të mëposhtme, duhet të aplikojnë përmes sistemit EDI të ATK-së, duke dorëzuar listën dhe pagat e të punësuarve, sipas deklaramit për muajin shkurt 2021.

Bizneset me nën-sektor gastronominë,

Bizneset që ushtrojnë aktivitetin në qendra tregtare të mbyllura

Bizneset me hapësira shfrytëzimi për fitnes dhe palestër dhe

Bizneset me linja aktive të licencuara për transport ndër-urban të udhëtarëve.



Ndryshimet eventuale që janë bërë pas datës 1 prill 2021 në deklaratën e tatimit në Paga “WM/CM” për muajin shkurt 2021 nuk merren parasysh në zbatimin e këtij subvencionimi.¹

Të punësuarit që kanë më shumë se një vend pune në sektorin publik, përfshirë edhe ndërmarrjet publike, nuk përfitojnë nga kjo masë.

Subvencionimi i qirasë bëhet në nivelin deri në 50% të qirasë neto, deri në një maksimum prej 2,500.-EUR për njësi/filiale, për bizneset qiramarrëse duke qenë i liruar nga tatimi, sipas legjislacionit në fuqi

Për subvencionim të qirasë mund të aplikojnë:

- Bizneset me aktivitet të vetëm gastronominë dhe
- Bizneset për njësitë që ushtrojnë aktivitetin në qendra tregtare të mbyllura.

Ndryshimet eventuale që janë bërë pas datës 1 prill 2021 në deklaratën e Tatimit të mbajtur në burim Qira “WR” për muajin shkurt 2021 nuk merren parasysh në zbatimin e këtij subvencionimi.²

Bizneset të cilat kanë përfituar nga masa 14 e Pakos Fiskale Emergjente, dhe të cilat nuk i janë përmbajtur kontratave 12-mujore për punëtorët ashtu siç parashihet me me Ligj, nuk përfitojnë nga subvencionimi i qirasë, përvec nëse kontrata është shkëputur ashtu si e kërkon Ligji.

^{1&2} Pika 5 & 7; Vendimi Nr: 01/08; Qeveria e Republikës së Kosovës; Prishtinë, 21.04.2021. E qasshme në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2021/04/Vendimet-e-Mbledhjes-se-8-te-te-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves....pdf?_cf_chl_jschl_tk__=1dbdbb8f18fdb88db61441bbad05c4ab5414068a-1619771311-0-AXmhdX3-REDvNn_wh6FuxyNQ9lbgEZrUNc50kkj82KE93JD7Cpmh4bWMNer1QQ8zAgRYZmDgDHjaHs_xcZ7zIFNImSamSdb1Lzoz2S7p1FVQMWwLUd1HHIn5T5G1w7aDXh oBPFpKac6j6c4q4mpnWguNI2zEJ6-MxzLXLInrdEi7s0LjD5-uekTOxr2n-Qx3ZQk1yWjRYSJASKzHtmYIMO7JhC_QNB5JIO1ypEdUMjpb0A-5_9YSkkS9ldckTj6ZG1nVBngaoyUA160pjTsoPS3-ukeGGFgSxTaO010gvuHAQT6z5WBCtiwxRlg1LR4KNW95H58REI5KMVp9KB_maPIEG3kwsPaKSx1xBXBqvY-vCrCF66h_5HqP-sn-4aVcjjVgP2240JIFsIQc7uirx_rkiwOr76OKZ_yfPpbVyA2ldwSmh-JF3sSgSf5GBsQ2FEn_DLISdGzOMcoSpWCD0vjNK681jZZQETNWO7bHCXLYClp9bjMLfLCADzBzPir2dD4AllYaVuQwVFI9Y3k

Si mund të aplikojnë përfituesit për masat e reja?

Përfituesit e këtyre masave duhet të aplikojnë përmes Sistemit Elektronik EDI, më së largu deri më

11 Maj 2021.

Të gjithë përfituesit që kanë të drejtë të aplikojnë, duhet fillimisht të kenë llogari të hapur në shërbimet elektronike EDI, në mënyrë që të kyqen dhe të kenë mundësi të bëjnë kërkesën për subvencionim.

Ndërmarrësit kur aplikojnë, duhet të ngarkojnë kontratën e qirasë sipas deklarimit në ATK

Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë plotësimit të informatave të kërkuara në sistem. Përfituesit duhen pasur kujdes sepse çdo mospërputhje apo pasaktësi rezulton me pamundësi të ekzekutimit të mjeteve financiare në llogarinë e përfituesit.

Për detaje më të hollësishme mbi procedurën e aplikimit ATK ka hartuar një "Udhëzues për Aplikim për Subvencionim të Pagave dhe Qirasë" i cili mund të shfletohet në vegzën në vazhdim:

https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2021/04/Udhezuesi_per_aplikim_per_Subvencionim.pdf



BULETINI I RIMËKËMBJES

maj 2021



Ky buletin është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për shoqëri të Hapur (KFOS). Pikëpamjet e shprehura në këtë buletin janë INDEP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të hapur (KFOS).